



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 139 prot.

Kamëz, më 24.10 .2024

V E N D I M

Nr. 105 .Datë 24/10 2024

MBI

“DHËNIE NDIHME EKONOMIKE PËR FAMILJE NË NEVOJË NGA
BUXHETI I BASHKISË”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 24.10.2024, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.78 Datë 18.10.2024 në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 24, nenit 55, pika 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, ligji nr.57/2019 neni 21 datë 18/07/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, Kreu IV, të Vendimit nr. 597 datë 04/09/2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, VKB nr.103 dt 18.12.2023 “ Mbi detajimin e buxhetit për vitin 2024, 2025, 2026; VKB nr. 6 datë 22.01.2024 mbi “Miratimin e kriterëve për trajtimin me ndihmë ekonomike për familjet në nevojë nga buxheti i bashkisë për vitin, 2024; Këshilli Bashkiak Kamëz”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e përdorimit të të ardhurave të bashkisë për ndihmë ekonomike me një fond prej **150.000 (njëqind e pesëdhjetëmijë)** lekë për muajin **Tetor** 2024. Fondi do të përballohet sipas strukturës buxhetore Gr 0, prog., 10430, Kap.5, Art 606.
2. Miratimin e dhënies së ndihmës ekonomike për familjen si më poshtë.
 - a)me vlerën 150,000 lekë si një rast i veçantë për gjendjen shëndetësore të djalit
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimit të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar.

N/KRYETAR KËSHILLI

MUNIR SHEHU

